"Ndërtim Tubacion Transmetimi Basen Presioni- Tunel- Partitar- Depo Daias".

Shtojca 11

(Shtojcë për t'u plotësuar nga Operatori Ekonomik)

DEKLARATË MBI KONTRATAT E LIDHURA DHE/ OSE NE PROCËS⁴

Deklaratë e operatorit ekonomik pjesëmarrës në procedurën e prokurimit që do të zhvillohet në datë _____ nga Autoriteti Kontraktor _____ me objekt _____ me fond limit _____.

Unë i nënshkruari _____ me cilësinë _____ të operatorit ekonomik _____ deklaroj se kam në proces dhe/ose jam shpallur fitues për kontratat e mëposhtme:

Nr.	Autoriteti kontraktor	Objekti i procedurës se prokurimi/kontratës	Vlera e shpallur fituese

Data e dorëzimit të deklaratës _____

Përfaqësuesi i ofertuesit

Nënshkrimi

Vula

⁴Kjo deklarate ka si qellim plotësimin e kriterit ligjor që operatorit ekonomik brenda së njëjtës periudhë nuk është kontraktor/nënkontraktor për kontratë/kontrata të lidhura dhe/ose është shpallur fitues, me vlerë të përbashkët ose të veçantë, më të madhe se 100 % i kufirit maksimal, që disponon, sipas licencës profesionale, të lëshuar nga autoriteti kompetent

"Ndërtim Tubacion Transmetimi Basen Presioni- Tunel- Partitar- Depo Daias".

Shënim: Nërastin e bashkimit të operatorëve ekonomikë, secili prej anëtarëve të bashkimit duhet të plotësojë këtë deklaratë.

"Ndërtim Tubacion Transmetimi Basen Presioni- Tunel- Partitar- Depo Daias".

Shtojca 12

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor]

1. KRITERET E PËRGJITHSHME TË PRANIMIT/KUALIFIKIMIT

Ofertuesi duhet të deklarojë se:

- a) Është i regjistruar në Qendrën Kombëtare të Biznesit dhe ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit. Në rastin kur ofertuesi është një organizatë jofitimprurëse, duhet të deklarojë se është i regjistruar si person juridik, sipas Ligjit Nr.8788, datë 07.05.2001 "Për Organizatat jo Fitimprurëse".
- b) nuk është në proces falimentimi, (statusi aktiv)
- c) nuk është dënuar për shkelje penale, në përputhje me Nenin 45/1 të LPP,
- ç) nuk është dënuar me vendim të gjykatës së formës së prerë, për vepra që lidhen me veprimtarinë profesionale.
- d) ka paguar të gjitha detyrimet për pagimin e tatimeve e të kontributeve të sigurimeve shoqërore, sipas legjislacionit në fuqi.

Edhe Ofertuesi i huaj duhet të deklarojë se i plotëson të gjitha kërkesat e renditura më sipër nëpërmjet paraqitjes së një vetëdeklarate me shkrim.

Nëse gjuha e përdorur në procedurë është gjuha shqipe, atëherë dokumentat në gjuhë të huaj duhet të shoqërohen me një përkthim të noterizuar në gjuhën shqipe.

Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomikë, çdo anëtar i grupit duhet të dorëzojë vetëdeklaratën e lartpërmendur.

Kriteret e Përgjithshme për Pranim, nuk duhet të ndryshohen nga autoritetet kontraktore.

Këto kritere duhet të plotësohen me dorëzimin e vetëdeklaratës me shkrim të subjektit, në ditën e hapjes së ofertës, sipas Shtojcës 8.

Në çdo rast, autoriteti kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik si më sipër.

Veç kësaj, nëse oferta dorëzohet nga një bashkim operatorësh ekonomikë, duhet të dorëzohen:

- a. Marrëveshja e noterizuar sipas së cilës bashkimi i operatorëve ekonomikë është krijuar zyrtarisht;
- b. Prokura e posaçme.

"Ndërtim Tubacion Transmetimi Basen Presioni- Tunel- Partitar- Depo Daias".

2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

a. *Përshkrimin e Ofertës, sipas Shtojcës 1;*

b. *Deklaratë për paraqitje oferte të pavarur, sipas Shtojcës 1/1;*

c. *Sigurimoferte, (nëse është zbatueshme) sipas Shtojcës 3;*

ç. *Deklaratë mbi përmbushjen e Specifikimeve teknike, sipas Shtojcës 5;*

d. *Deklaratë mbi Konfliktin e Interesit sipas Shtojcës 7;*

dh. *Deklaratë mbi garantimin e zbatueshmërisë së dispozitave ligjore në marrëdhëniet e punës Shtojcës 8/1;*

e. *Formular vlerësimi sipas Shtojcës 9;*

f. *Deklaratën bi disponueshmërinë e mjeteve sipas Shtojcës 10;*

g. *Deklaratë mbi kontratat e lidhura apo ne proces, sipas Shtojcës 11;*

gj. *Vërtetimin që konfirmon shlyerjen e të gjitha detyrimeve të maturuara të energjisë elektrike të kontratave të energjisë që ka operatori ekonomik që është i regjistruar në Shqipëri.*

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.1. Per kapacitetin ligjor/profesional i operatorëve ekonomikë:

- **Sipas kriterëve të përgjithshme të pranimit/kualifikimit (Shtojca 12)**

2.2. Per kapacitetin ekonomik dhe financiar:

2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

1. Operatori ekonomik duhet të paraqesë kopje të bilanceve për vitet (2017, 2018, 2019), të paraqitur pranë autoritetit përkatës Dega e Tatim Taksave, të konfirmuar nga ky autoritet në të cilat duhet të rezultojë se nuk ka dalë me humbje të paktën në dy vite të njëpasnjëshme si dhe të shoqëruara me Akt Ekspertizën e Ekspertit Kontabel të Autorizuar, në rastin kur shoqëria ofertuese është subjekt që në përputhje me aktet ligjore në fuqi duhet të kryejë akt ekspertizën e ekspertit kontabel të autorizuar.

2. Kopje të deklaramit të xhiros vjetore gjatë 3 (tri) viteve të fundit ushtrimore (2017, 2018, 2019) lëshuar nga autoriteti përkatës, vlera mesatare e se ciles duhet te jete jo me e vogel se 50% e vlerës së fondit limit perkatesisht: **394.774.552 (treqind e nëntëdhjetë e katër milion e shtatëqind e shtatëdhjetë e katër mijë e pesëqinde pesëdhjetë e dy) lekë pa TVSH**

3. Operatori ekonomik duhet të paraqesi vërtetim për shlyerjen e taksave vendore të parashikuara nga Pushteti Vendor për vitin (2019, 2020), ku të përfshihet kësti për periudhën përkatëse të maturuar sipas përcaktimeve të ligjit nr.9632 datë 30.10.2006 "Për sistemin e taksave vendore", i ndryshuar. Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomikë, çdo anëtar i grupit duhet të dorëzojë vërtetimin lëshuar nga Autoriteti përkatës në të cilën është regjistruar sipas QKR.

"Ndërtim Tubacion Transmetimi Basen Presioni- Tunel- Partitar- Depo Daias".

3.1. *Operatorët* ekonomik pjesmarrës nuk duhet të rezultojnë debitorë pranë Ujesjellës Kanalizime Tiranë sh.a (Autoriteti Kontraktor gëzon të drejtën e verifikimit mbi çdo operator ekonomik pjesmarrës). Në rast se operatorët ekonomik pjesmarrës rezultojnë debitorë ndaj UKT sh.a përbën kusht skualifikimi.

2.3 Kapaciteti teknik:

Përsa i përket aftësisë teknike e profesionale, Operatori Ekonomik duhet të përmbushë kërkesat e mëposhtme minimale të cilat vendosen nga Autoriteti Kontraktor si më poshtë: Përvojë e suksesshme në realizimin e të paktën:

- a) Punë të ngjashme për një objekt të vetëm me vlerë jo më të vogël se 50% e vlerës së përlllogaritur të kontratës që prokurohet dhe konkretisht: **394.774.552 (treqind e nëntëdhjetë e katër milion e shtatëqind e shtatëdhjetë e katër mijë e pesëqinde pesëdhjetë e dy) lekë pa TVSH** të realizuar gjatë tri viteve të fundit, datë e përlllogaritur nga data e hapjes se ofertave.
- b) Punë të ngjashme deri ne nje kufi ku vlera monetare totale e punëve të kryera e marrë së bashku gjatë tre viteve të fundit, datë e përlllogaritur nga data e hapjes se ofertave. është në një vlerë sa dyfishi i vlerës limit të kontratës që prokurohet .

Plotesimi i njerit prej dy kushteve te siperpermendura e bën oferten te kualifikueshme.

Vlerësimi i përvojës së suksesshme të Operatorit Ekonomik do të kryhet bazuar në deklaratat e dokumentat e mëposhtme:

- a) Për kontrata të realizuara me ente publike,operatori ekonomik duhet të paraqesë dokumentacionin e mëposhtëm:
 1. Deklaratën sipas shtojcës Nr. 9, shoqëruar me:
 2. Kontratë Sipërrmarje
 3. Situacionin përfundimtar;
 4. Aktin e kolaudimit;
 5. Çertifikaten e marrjes ne dorezim/ Çertifikaten e përkohëshme të marrjes ne dorezim
- b) Për kontrata të realizuara me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë dokumentacionin e mëposhtëm:
 1. Deklaratën sipas shtojcës Nr. 9, shoqëruar me:
 2. Kontratë Sipërrmarje ;

"Ndërtim Tubacion Transmetimi Basen Presioni- Tunel- Partitar- Depo Daias".

3. Situacionin përfundimtar;
4. Akt kolaudimi objekti;
5. Çertifikaten e marrjes ne dorezim te objektit;
6. Fatura tatimore për situacion përfundimtar.

Pika 1/a plotësohet nga anëtari i cili ka përqindjen më të madhe të pjesëmarrjes në bashkim. Anëtarët e tjerë të bashkimit do të paraqesin kontratat e ngjashme në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim. Kurse pika 1/b duhet të plotësohet nga të gjithë anëtarët e bashkimit në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim.

2.4 Licensa profesionale, lidhur me ekzekutimin e punëve të kontratës:

Licenca e shoqërisë e vlefshme për kategoritë e mëposhtme:

- N.P –1C (Punime gërmimi në tokë)
- N.P– 2B (Ndërtime Civile dhe Industriale)
- N.P –7F (Ujësjellësa, gazsjellësa, vajsjellësa, vepra kullimi e vaditje)
- N.P–11A (Ndërtime për N/Stacionet,kabinat e transformatorëve, linja të TN e të mesëm dhe shpërndarjen e energjisë)
- N.S – 1A (Punime për prishjen e ndërtimeve)
- N.S–13A (Impiante dhe linja telefonie dhe telekomunikacioni)
- N.S–14A (Impiante te brendshme elektrike ,telefoni,etj)
- N.S –16B (Ndertimi I impjanteve te ujit te pijshem dhe pastrami I tij)
- N.S–18A (Punime topogjeodezie)

sipas modelit të lëshuar nga MPPT/MTI;

Për Operatorët e huaj të bëhet njehsimi i licencës profesionale që disponojnë nga vendi i origjinës pranë Institucionit përkatës, në plotësim të licencave profesionale të kërkuara për ekzekutimin e kontratës.

2.5 Operatori ekonomik duhet të jetë i pajisur me licencat e nevojshme (lëshuar nga QKL) për zbatimin e kontratës. Për këtë duhet të paraqesin licencat:

a) Licencë Kodi III.2.B Grumbullim dhe Transport i Mbetjeve Urbane.

b) Licencë Kodi III.2.B Për Grumbullimin dhe Transportin e Mbetjeve Inerte dhe Dherave.

"Ndërtim Tubacion Transmetimi Basen Presioni- Tunel- Partitar- Depo Daias".

2.6 Kandidati ofertues duhet të përcaktoje me anë të një deklaratë (nga Administratori i shoqërisë) Drejtuesin Teknik të punimeve në objekt të përfshirë në licencën e shoqërisë dhe të deklaroje se ai nuk është i angazhuar në kontrata të tjera dhe do të jetë i pranishëm gjatë gjithë kohës që do të kryhen punimet në objekt, shoqeruar me dokumentacionin e mëposhtem

- i. Libreze pune (perkatase)
- ii. Diplomë
- iii. Kontrate pune e vlefshme (përkatëse)

Në rastin e Bashkimit të operatorëve Ekonomik secili operator duhet të përcaktojë me anë të një deklaratë Drejtuesin teknik të punimeve në objekt I cili duhet të jetë i përfshirë në licencën e shoqërisë dhe të deklaroje se ai nuk është i angazhuar në kontrata të tjera dhe do të jetë i pranishëm gjatë gjithë kohës që do të kryhen punimet në objekt në varësi të vlerës të preventivit të punimeve që ka marrë përsipër sipas përqindjes së bashkëpunimit.

2.7 Një punësim mesatar i të paktën 300 (treqind) personave, për periudhën Dhjetor 2019- Nëntor 2020 të vërtetuar me;

- Vërtetim të lëshuar nga Sigurimet shoqërore ose Administrata Tatimore, ku të specifikohet numri i punonjësve për secilin muaj; për periudhën Dhjetor 2019- Nëntor 2020 të vërtetuar me;
- Listë pagesat e punonjësve të plotësuar rregullisht sipas formatit e përcaktimeve që kërkohet nga legjislacioni në fuqi për secilin muaj të periudhës së mësipërme.

Punonjësit e sipërcituar duhet të jenë të siguruar me ditë të plota pune.

2.8 Operatorët ekonomik pjesëmarrës duhet të kenë të punësuar si staf teknik të përfshirë në licencën e shoqërisë për kryerjen e të gjitha punimeve në këtë objekt, të vërtetuar me kontratë pune të vlefshme, diplomë, si dhe të figurojnë në listpagesat e shoqërisë për të paktën 12 (dymbëdhjetë) muajt e fundit stafi inxhinierik si më poshtë:

- Inxhinier Ndërtimi (1)
- Inxhinier Elektrik (1)
- Inxhinier Hidroteknik (1)
- Inxhinier Mekanik (1)
- Inxhinier Mjedisi (1) (profil trajtim ujrash)
- Inxhinier Gjeodet(1)

Punonjësit e sipërcituar duhet të jenë të siguruar me ditë të plota pune.

2.9 Operatori Ekonomik duhet të ketë në stafin e tij të punësuar dhe të rregjistruar sipas legjislacionit në fuqi për gjashtë muajt e fundit : dy inxhinier ndërtimi , një inxhinier elektrik, një inxhinier topograf, dy inxhinier hidroteknik, *1(një) ekspert të pajisur me certifikatë "Përgjegjës për dëmet në mjedis" në përputhje me klauzolat e ligjit 10431, datë 09.06.2011"*

"Ndërtim Tubacion Transmetimi Basen Presioni- Tunel- Partitar- Depo Daias".

Për mbrojtjen e mjedisit", lëshuar nga Ministria e Mjedisit për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis.(te paraqitet dhe certifikata).

Punonjësit e sipërcituar duhet të jenë të siguar me ditë të plota pune.

2.10 Të ketë në stafin e punonjesve te pasqyruar ne list pagesat e shoqërisë për gjashtë muajt e fundit të pakten 40 (dyzetë) punonjës të pajisur me deshmi kualifikimi te sigurimit teknik nga ISHTI ose nga institucione ekuivalente me të, ku nga keta te jene te pakten:

Grupi I- 10(dhjetë) punonjës nga të cilët pesë të jenë murator dhe pesë të jenë karpentier

Grupi II-18(tetëmbëdhjetë) punonjës nga të cilët pesë të jenë saldator, pesë të jenë teknik ndërtimi dhe gjashtë të jenë hidraulik dhe dy mekanikë

Grupi III- 6(gjashtë) punonjëstë cilët të jenë elektromekanikë

Grupi IV- 3 (tre) punonjës elektrikist

Grupi V- 3 (tre) punonjës elektrikist

(Per punonjesit e siperpermendur te paraqiten deshmite perkatese te kualifikimit te sigurimit teknik, kontratat e punes te vlefshme)

Punonjësit e sipërcituar duhet të jenë të siguar me ditë të plota pune.

2.11 Operatori ekonomik ofertues duhet të ketë të punësuar minimalisht 8(tetë) punonjës manovratorë të mjeteve të rënda nga te cilet katër automakiniste dhe katër eskavatoriste. Për këto punonjës duhet të paraqitet kontrata e punës e vlefshme, dëshmitë e drejtimit (të vlefshme), lëshuar nga institucionet përkatëse si dhe të figurojnë në listpagesat e shoqërisë per gjashte muajt e fundit
Për rastin kur mjetet dhe makineritë sigurohen nëpërmjet kontratës së qerasë atëherë autoriteti kontraktor për punonjësit manovrator mund te paraqese kontratë punësimi ose të figurojnë në listpagesat e shoqërisë per gjashtë muajt e fundit .

Punonjësit e sipërcituar duhet të jenë të siguar me ditë të plota pune.

2.12. Operatorët ekonomik pjesmarrës duhet të kenë të punësuar si staf mbështetës për kryerjen e të gjithave punimeve në këtë objekt të vërtetuar me kontratë pune të vlefshme dhe dëshmi aftësie të lëshuara nga subjektet e akredituara si dhe të figurojnë në list pagesat e shoqërisë për të paktën 3 (tre) muajt e fundit stafin si më poshtë cituar:

2 (dy) hidraulikë

2(dy) elektrikist

2(dy) specialist montim tubash

2(dy) saldator

Punonjësit e sipërcituar duhet të jenë të siguar me ditë të plota pune.

2.13. Te kete ne staf te punësuar:

a. Inxhinier – Auditues energjie (1 person) (i pajisur me “Certifikate per auditimin e energjise)

b. ekspert zjarrfikës te certifikuar (1 person)

(Per inxhinierin e eficenses se energjise duhet te kete keto dokumenta provues: Kontrata e punes (e vlefshme per te pakten periudhen e parashikuar te ndertimit), Certifikata (Dip) per eficensen e energjise, Diploma, për ekspertin zjarrfikës certifikata e ekspertit zjarrfikës si dhe Kontrata e punes (e vlefshme per te pakten periudhen e parashikuar te ndertimit).Punonjësit e sipërcituar duhet të figurojnë në list pagesat e shoqërisë për të paktën 3 (tre) muajt e fundit.

Punonjësit e sipërcituar duhet të jenë të siguar me ditë të plota pune.

"Ndërtim Tubacion Transmetimi Basen Presioni- Tunel- Partitar- Depo Daias".

2.14 Operatori ekonomik ofertues duhet të ketë në stafin e tij 2(dy) specialist të çertifikuar për punime në lartësi, Kontrata e Punës , çertifikata për “Punime në Lartësi” si dhe të figurojnë në listpagesat e shoqërisë për të paktën për tre muajt e fundit.

Punonjësit e sipërcituar duhet të jenë të siguruar me ditë të plota pune.

2.15 Operatori ekonomik ofertues duhet të ketë të punësuar 1 (një) punonjës që të disponojë çertifikatë si "Përgjegjës për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit në punë" në përputhje me klauzolat e ligjit Nr. 10327 date 18/02/2010 "Për sigurinë dhe shëndetin në punë" dhe V.K.M nr. 312, date 05.05.2010 "Për miratimin e rregullores "Për sigurinë në kantier", të shoqëruar me kontratë individuale të punës të vlefshme, Diplome/certifikate, si dhe të figurojë në listëpagesat e shoqërisë për të paktën 3(tre) muajt e fundit. *Në rastin e bashkimit të Operatorëve ekonomikë, secili prej Operatorëve duhet të ketë pjesë të stafit të tij 1 (një) "Përgjegjës për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit në punë".*

2.16 Operatori ekonomik duhet të paraqesë grafikun e punimeve të detajuar sipas zërave të preventivit(bashkëlidhur dst) të shprehur në afatin kohor të përcaktuar në dokumentate tenderit

2.17 Operatori ekonomik duhet të paraqesë certifikatat si më poshtë:

- Shoqëria duhet të paraqesë Certifikaten e cilesise se punimeve **ISO 9001- 2015** (e vlefshme). *(Në rastet e Bashkimit të Operatorëve ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë Çertifikatën ISO sipas zerave te punimeve që do të marrë përsipër të realizojë sipas akt marrëveshjes).*
- Shoqëria duhet të paraqesë Certifikate **ISO 14001-2015** (e vlefshme). *(Në rastet e Bashkimit të Operatorëve ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë Çertifikatën ISO sipas zerave te punimeve që do të marrë përsipër të realizojë sipas akt marrëveshjes).*
- Shoqëria duhet të paraqesë certifikatë **OHSAS 18001-2007**(e vlefshme)/ose SSH 45001-2018 (*Në rastet e Bashkimit të Operatorëve ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë Çertifikatën ISO sipas zerave te punimeve që do të marrë përsipër të realizojë sipas akt marrëveshjes).*
- Shoqëria duhet të paraqesë certifikatë **PAS 99-2012**(e vlefshme)(*Në rastet e Bashkimit të Operatorëve ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë Çertifikatën ISO sipas zerave te punimeve që do të marrë përsipër të realizojë sipas akt marrëveshjes).*
- Shoqëria duhet të paraqesë certifikatë **ISO 39001 -2012** (e vlefshme) *(Në rastet e Bashkimit të Operatorëve ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë Çertifikatën ISO sipas zerave te punimeve që do të marrë përsipër të realizojë sipas akt marrëveshjes)*
- Shoqëria duhet të paraqesë certifikatë **ISO EN 3834-2 :2006** (e vlefshme)(*Në rastet e Bashkimit të Operatorëve ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë Çertifikatën ISO sipas zerave te punimeve që do të marrë përsipër të realizojë sipas akt marrëveshjes)*

2.18 Dëshmi për mjetet e pajisjet teknike, që ka në dispozicion apo mund ti vihen në dispozicion operatorit ekonomik, që nevojiten për ekzekutimin e kontratë (Shtojca 10).

Dokumenta Standarde të Tenderit

"Ndërtim Tubacion Transmetimi Basen Presioni- Tunel- Partitar- Depo Daias".

<i>Mjetet</i>	<i>Sasia</i>	<i>Gjendja</i>
Kamion vetëshkarkues (kapaciteti mbajtës minimum 3.5(tre pikë pesë) ton dhe maksimumi 5(pesë) ton për secilin kamion	10 copë	Pronësi ose me qera
Fadrome me goma	2 copë	Pronësi ose me qera
Fabrikë betoni paisur me QKL	1 copë	Pronësi ose me qera
Eskavator me zinxhir	6 cope	Pronësi ose me qera
Eskavator me goma	2 copë	Pronësi ose me qera
Kamion vetëshkarkues (kapaciteti mbajtës minimum 11(njembëdhjete) ton dhe maksimumi 17(shtatëmbëdhjete) ton për secilin kamion	8 copë	Pronësi ose me qera
Autobetoniere	3 copë	Pronësi ose me qera
Mini eskavator	2 copë	Pronësi ose me qera
Autovinc	2 cope	Pronësi ose me qera
Vibrator betoni	2 copë	Pronësi ose me qera
Autopompe betoni	2 copë	Pronësi ose me qera
Makine per ngjitje tubash PE	2 copë	Pronësi ose me qera
Trencher për hapje kanali minimumi 20 Ton	1 copë	Pronësi ose me qera
Autobot uji	2 copë	Pronësi ose me qera
Sharrë asfalti	2copë	Pronësi ose me qera
Eskavator me cekic pneumatik	2 cope	Pronësi ose me qera
Motosharrë	2 copë	Pronësi ose me qera
Frezë	2copë	Pronësi ose me qera
Rrul vibrues me tonazh 2-5 ton secili rrul	2 cope	Pronësi ose me qera
Sonde shpimi horizontal	2 cope	Pronësi ose me qera
Asfalto shtruese	2 cope	Pronësi ose me qera
Paisje elektronike për matjen e presionit të ujit sipas standartit EN805 me printer automatik elektronik	1 cope	Pronësi ose me qera
Fshesë asfalti	2 cope	Pronësi ose me qera
Autobitumatriçe	1 cope	Pronësi ose me qera
Fabrikë asfalti paisur me QKL	1 cope	Pronësi ose me qera

Te paraqiten mjete dhe pajisje të mbrojtjes në punë të punëtorëve, personelit si më poshtë:

- Kokore minimumi 300 copë
- Rripa lidhës sigurimi për punime në lartësi minimumi 20 copë
- Fikëse zjarri të lëvizshme me kapacitet 5-7 litra secila minimumi 10 copë
- Prozhektorë ndriçimi natën minimumi 6 copë
- Komplet i ndihmës së shpejtë minimumi 20 copë
- Tabela paralajmëruese për sigurinë në objekt minimumi 30 copë

"Ndërtim Tubacion Transmetimi Basen Presioni- Tunel- Partitar- Depo Daias".

- a) Për mjetet në pronësi duhet të paraqitet: a) dokumenti që verteton regjistrimin e mjetit (akti i pronësisë); b) leje qarkullimi; c) çertifikate e kontrollit teknik; d) siguracion mjeti, (i vlefshëm); e) çertifikatë për transport mallrash brënda vëndit (e vlefshme).
- b) Për mjetet e deklaruar me qera duhet të paraqitet: a) kontrata përkatëse noteriale e qerasë e cila duhet të jetë e vlefshme për të gjithë periudhën e realizimit të kontratës, objekt i këtij prokurimi b) dokumenti që verteton regjistrimin e tij (akti i pronësisë) c) leje qarkullimi; ç) çertifikaten e kontrollit teknik, d) siguracion mjeti (i vlefshëm); e) çertifikatë për transport mallrash brënda vëndit për të tretë (e vlefshme).
- c) Për mjetet e deklaruar që transportojnë mallra të klasifikuara sipas legjislacionit në fuqi të rrezikshme, duhet të paraqitet çertifikatë për transport mallrash të rrezikshëm lëshuar nga institucionet perkatese (e vlefshme).
- d) *Per fabriken e prodhimit te betonit, ne rast se eshte ne pronesi duhet te paraqitet akti i pronesise i shoqeruar me leje mjedisore leshuar nga QKL Kodi III.1.B. Ne rast se operatori ekonomik ka kontrate qeraje duhet te paraqitet akti i pronesise se qiradhensit shoqeruar me lejen mjedisore leshuar nga QKL Kodi III.1.B. Kontrata e qerases duhet te jete e noterizuar, ku të specifikohet objekti i kontratës dhe afati i saj të jetë i vlefshëm per periudhen e zbatimit te kontrates objekt prokurimi.*

*Për fabrikën e betonit ,operatori ekonomik duhet te jete i certifikuar me ISO ne prodhim
Beton si me poshte: ISO 9001:2015*

- e) *Per fabriken e prodhimit te asfaltit, ne rast se eshte ne pronesi duhet te paraqitet akti i pronesise i shoqeruar me leje mjedisore leshuar nga QKL Kodi III.1.B. Ne rast se operatori ekonomik ka kontrate qeraje duhet te paraqitet akti i pronesise se qiradhensit shoqeruar me lejen mjedisore leshuar nga QKL Kodi III.1.B. Kontrata e qerases duhet te jete e noterizuar, ku të specifikohet objekti i kontratës dhe afati i saj të jetë i vlefshëm per periudhen e zbatimit te kontrates objekt prokurimi.*

*Për fabrikën e asfaltit ,operatori ekonomik duhet te jete i certifikuar me ISO ne prodhim
Asfalti : ISO 9001:2015*

- f) Për pajisjet teknike, të cilat janë në pronësi të operatorit ekonomik, duhet të paraqitet kontrata e shitblerjes/fatura tatimore e shitjes si dhe dokumenti me të dhënat teknike të pajisjes ndërsa kur janë të marra me qera duhet të paraqitet kontrata e qerasë, fatura tatimore e shitjes/ kontrata e shitblerjes si dhe dokumenti me të dhënat teknike të pajisjes. Në rastin kur fatura është lëshuar nga subjekte që nuk janë të regjistruar si tatimpagues të TVSH-së duhet të shoqërohet me kuponin tatimor.
- g) Për mjetet dhe pajisjet teknike që ka deklaruar operatori ekonomik duhet të paraqesë foto të qarta për secilin mjet dhe pajisje. Në rastin e mjeteve të treguara duhet të jetë e dukshme ne nje foto te vetme mjeti dhe targa e tij.

"Ndërtim Tubacion Transmetimi Basen Presioni- Tunel- Partitar- Depo Daias".

- h) Operatori ekonomik duhet të paraqesë deklaratë me anë të së cilës pranon verifikimin e mjeteve dhe pajisjeve të deklaruara në shtojcën 10 në çdo kohë deri në përfundimin e kontratës nga Autoriteti Kontraktor.
- i) Operatori ekonomik duhet të paraqesë një deklaratë me anë të së cilës deklaron se mjetet dhe pajisjet e deklaruara sipas shtojcës 10 nuk janë të angazhuara në kontrata të tjera dhe nuk janë të deklaruara në procedurat të shpallura fitues nga Autoriteti Kontraktor, UKT sha.
- j) Operatori ekonomik duhet të paraqesë një deklaratë për vendndodhjen e mjeteve në pronesi ose me qera me qellim verifikimi nga Autoriteti Kontraktor.

2.19. Operatori ekonomik pjesmarrës duhet të paraqesë Kontrate furnizimi me furnizuesin e tubave që do të vendosen në objekt, i shoqëruar me certifikate ISO 9001:2015 të prodhuesit të mallit dhe katalogjet teknike të mallit të kërkuar, në rast se katalogjet janë në gjuhë të huaj operatori ekonomik duhet të paraqesë të përkthyer dhe noterizuar sipas legjislacionit në fuqi.

Të gjithë dokumentat duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara të tyre. Rastet e mos-dorëzimit të një dokumenti, ose të dokumentave të rreme e të pasakta, konsiderohen si kushte për skualifikim.

"Ndërtim Tubacion Transmetimi Basen Presioni- Tunel- Partitar- Depo Daias".

Shtojca 13

(Shtojcë për t'u plotësuar nga autoriteti kontraktor)

PROJEKTI I ZBATIMIT DHE SPECIFIKIMET TEKNIKE

Përshkrimi i të dhënave teknike tëpunëve objekt prokurimi të përshkruara sa më saktë dhe në mënyrë të plotë, duke krijuar kushte për konkurrim të paanshëm e të hapur ndërmjet të gjithë kandidatëve e ofertuesve. Kur është e mundur, specifikimet teknike duhet të përcaktohen në mënyrë të tillë që të kuptohen nga personat me aftësi të kufizuara.

KUJDES

Specifikimet teknike nuk duhet të kenë asnjë kërkesë apo referencë të ndonjë markë apo emër i veçantë, patentë, vizatim ose tip, origjinë specifike, prodhues ose sipërmarrës shërbimi, përveç rasteve kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme, e përshkrimit të kërkesave, me kusht që fjalët “ose ekuivalent” të përfshihen detyrimisht në këto specifikime.

Skicimet, Planimetritë e Objektivit etj:

Specifikimet Teknike tëMaterialeve:

Grafiku i Punimeve:

Përshkrimi i kërkesave të zbatimit të shërbimeve në lidhje me to:

Dokumenta Standarde të Tenderit
"Ndërtim Tubacion Transmetimi Basen Presioni- Tunel- Partitar- Depo Daias".

Shtojca 14

(Shtojcë për t'u plotësuar nga autoriteti kontraktor)

PREVENTIVAT E PUNIMEVE

Dokumenta Standarde të Tenderit
"Ndërtim Tubacion Transmetimi Basen Presioni- Tunel- Partitar- Depo Daias".

Shtojca15

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor]

NJOFTIM STANDART PËR OFERTUESIN E SKUALIFIKUAR⁵

[Vendi dhe data]

[Emri dhe adresa e autoritetit kontraktor]

[Adresa e ofertuesit]

I/E Nderuar Z. /Zj. <emri i kontaktit>

Ju falenderoj për pjesëmarrjen në procedurën e lartpërmendur të prokurimit publik. Procedura e kryer në përputhje me Ligjin nr. 9643 datë 20.11.2006Për Prokurimin Publik.

Oferta juaj u vlerësua me kujdes sipas kushteve dhe kërkesave të përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e ofertës. Me keqardhje ju informoj se u s'kualifikuat, sepse oferta e dorëzuar nga ju u refuzua për shkak të arsyes (-ve) së/të mëposhtme:

Nëse mendoni se Autoriteti Kontraktor ka shkelur LPP ose RrPP gjatë procedurës së prokurimit publik, atëherë keni të drejtë të filloni një procedurë rishikimi siç parashikohet në Kreun VII të LPP-së.

Edhe pse nuk mundëm të përdornim shërbimet tuaja në këtë rast, besoj se do të vazhdoni të jeni i interesuar në nismat tona të prokurimit.

Me respekt
<Emri>

⁵ Ky njoftim duhet të përdoret në rastin e procedurave të prokurimit që zhvillohen në rrugë shkresore

"Ndërtim Tubacion Transmetimi Basen Presioni- Tunel- Partitar- Depo Daias".

Shtojca 16

[Shtojcë për t'u plotësuar Autoriteti Kontraktor]

FORMULARI I NJOFTIMIT TËFITUESIT

[Data _____]

Për: [Emri dhe adresa e ofertuesit të shpallur fitues]

Procedura e prokurimit:

Numri i referencës së procedurës/lotit:

Përshkrim i shkurtër i kontratës: [Sasia ose qëllimi dhe kohëzgjatja e kontratës]

Publikime të mëparshme (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike [Data] [Numri]

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit: çmimi më i ulët oferta ekonomikisht më e favorshme

Njoftojme se, kane qenë pjesëmarrës në procedurë këta ofertues me vlerat përkatëse të ofruara:

1. _____
Emri i plotë i shoqërisë _____ numri i NIPT-it _____

Vlera _____
(me numra dhe fjalë)

2. _____
Emri i plotë i shoqërisë _____ numri i NIPT-it _____

Vlera _____
(me numra dhe fjalë)

Etj. _____

Janë skualifikuar ofertuesit e mëposhtëm:

1. _____
Emri i plotë i shoqërisë _____ numri i NIPT-it _____

2. _____
Emri i plotë i shoqërisë _____ numri i NIPT-it _____

Përkatësisht për arsyet e mëposhtme:

"Ndërtim Tubacion Transmetimi Basen Presioni- Tunel- Partitar- Depo Daias".

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë *[emri dhe adresa e ofertuesit të shpallur fitues]* se oferta e paraqitur, me një vlerë të përgjithshme prej *[shuma përkatëse e shprehur në fjalë dhe shifra]*/pikët totale të marra *[_____]* është identifikuar si oferta e suksesshme.

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqisni pranë *[emri dhe adresa e autoritetit kontraktor dhe referenca e kontaktit]* sigurimine kontratës, siç parashikohet në dokumentat e tenderit, brenda _____ ditëve nga dita e marrjes/publikimit të këtij njoftimi.

Në rast se nuk pajtoheni me këtë kërkesë, ose tërhiqeni nga nënshkrimi i kontratës, do të konfiskohet sigurimi i ofertës suaj (nëse është kërkuar) dhe kontrata do t'i akordohet ofertuesit vijues në klasifikimin përfundimtar, oferta e të cilit është dorëzuar me një vlerë të përgjithshme prej *[vlera përkatëse e shprehur në fjalë dhe shifra]*, siç parashikohet në nenin 58 të Ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik", i ndryshuar.

Njoftimi i Klasifikimit është bërë në datë _____

Ankesa: ka ose jo _____

(nëse ka) ka marrë përgjigje në datë _____

[Titullari i autoritetit kontraktor]

"Ndërtim Tubacion Transmetimi Basen Presioni- Tunel- Partitar- Depo Daias".

Shtojca 17

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor në rastin e marrëveshjes kuadër]

FORMULARI I NJOFTIMIT TË OPERATORËVE EKONOMIKË TË SUKSESSHËM NË MARRËVESHJEN KUADËR

[Data]

Për: [Emri dhe adresa e operatorëve ekonomikë të shpallur fitues]

1. _____
2. _____
3. _____

* * *

Procedura e prokurimit: _____

Numri i referencës së procedurës/lotit:

Përshkrim i shkurtër i kontratës: *[Sasia, objekti , kohëzgjatja e kontratës etj]*

Publikime të mëparshme (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike [Data] [Numri]

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit: oferta ekonomikisht më e favorshme çmimi më i ulët

Njoftojmë se, kanë qenë pjesëmarrës në procedurë këta operatorë ekonomikë, me shumatoren e çmimeve për njësi të ofruar/ me vlerat përkatëse të ofruara:

1. _____
Emri i plotë i shoqërisë *numri i NIPT-it*

Shumatorja e çmimeve për njësi të ofruar/vlera _____
(me numra dhe fjalë)

2. _____
Emri i plotë i shoqërisë *numri i NIPT-it*

Shumatorja e çmimeve për njësi të ofruar/vlera _____

"Ndërtim Tubacion Transmetimi Basen Presioni- Tunel- Partitar- Depo Daias".

(me numra dhe fjalë)

Etj. _____

Janë skualifikuar operatorët ekonomikë të mëposhëm:

1. _____
Emri i plotë i shoqërisë *numri i NIPT-it*

2. _____
Emri i plotë i shoqërisë *numri i NIPT-it*

Perkatësisht për arsyet e mëposhtme:

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë se janë identifikuar si operatorë ekonomikë të suksesshëm:

1. _____
Emri i plotë i shoqërisë *numri i NIPT-it*

Shumatorja e çmimeve për njësi të ofruar/Vlera _____/Pikët totale të marra _____
(me numra dhe fjalë)

2. _____
Emri i plotë i shoqërisë *numri i NIPT-it*

Shumatorja e çmimeve për njësi të ofruar/Vlera _____/Pikët totale të marra _____
(me numra dhe fjalë)

Etj. _____

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqiteni pranë [*emri dhe adresa e autoritetit kontraktor dhe referenca e kontaktit*], brenda _____ ditëve nga dita e marrjes/publikimit të këtij njoftimi për të lidhur draft marrëveshjen.

Njoftimi i Klasifikimit është bërë në datë _____

Ankesa: ka ose jo _____
(nëse ka) ka marrë përgjigje në datë _____

[Titullari i autoritetit kontraktor]

Shtojca 18

KUSHTET E PËRGJITHSHME TË KONTRATËS Punët – Procedura e Hapur

Neni 1: Qëllimi

- 1.1 Këto kushte të përgjithshme të kontratës (KPK) do të zbatohen për kryerjen e Punëve të prokuruarra ne bazë të legjislacionit të prokurimit.
- 1.2 Ligji për Prokurimin Publik në Republikën e Shqipërisë parashikon se dispozitat e Kodit Civil Shqiptar do të zbatohen për kontratat e prokurimit publik. Disa dispozita të Kodit Civil janë rishprehur në KPK me qëllim që të rrisin transparencën e kushteve të kontratës. Megjithatë, citimi i disa dispozitave këtu nuk mohon në asnjë mënyrë zbatimin e dispozitave të tjera të Kodit Civil të kësaj kontrate.
- 1.3 Në mënyrë të ngjashme, disa dispozita të Ligjit mbi Prokurimin Publik janë rishprehur në KPK me qëllim që të rrisin transparencën e ligjit që rregullon prokurimin publik. Megjithatë, citimi i disa dispozitave këtu nuk mohon në asnjë mënyrë zbatimin e dispozitave të tjera të Ligjit mbi Prokurimin Publik mbi të drejtat, detyrat dhe detyrimet e palëve.
- 1.4 KPK do të zbatohen deri në atë masë që të mos lënë mënjanë kushtet ose dispozitat e parashikuara në pjesë të tjera të kontratës.
- 1.5 Kushtet e kontratës përfshijnë gjithashtu Kushtet e Veçanta të Kontratës (KVK). Në rast se ka një konflikt midis KPK dhe KVK, KVK do të mbizotërojnë mbi KPK.

Neni 2: Përkufizime

- 2.1 "Preventiv total" do të thotë volumet e punes te dhena ne projekt te cilat jane orientuese, plotesuar me cmimin total të përcaktuar që është pjesë e Ofertes në një kontratë me çelsa ne dore.

"Ndërtim Tubacion Transmetimi Basen Presioni- Tunel- Partitar- Depo Daias".

- 2.2 “Preventiv per njesi” do të thotë volumet e punes te dhena ne projekt shoqeruar me cmimet per njesi te pandryshuara që janë pjesë e Ofertes në një kontratë me punime ne matje.
- 2.3 “Afatii realizimit te punimeve” do të thotë data që Punët duhet të perfundojnë siç është shprehur në Grafikun për realizimin Punimeve , e vertetuar nga enti prokurues.
- 2.4 “Kontratë” do të thotë marrëveshja e shkruar e lidhur midis Autoritetit Kontraktor dhe kontraktorit që përbëhet nga dokumentat e tenderit duke përfshirë KPK dhe KVK, të gjitha bashkangjitjet dhe formularët e plotësuar dhe të gjitha dokumentat e tjera që përfshihen në referimin e çdo dokumenti.
- 2.5 “Cmim kontrate” do të thotë çmimi që i paguhet kontraktorit sipas kontratës për zbatimin e plotë dhe të përpiktë të detyrimeve të tij kontaktore.
- 2.6 “Realizimi i punimeve” do të thotë data e vërtetuar nga Autoriteti Kontraktor se Punët janë mbaruar.
- 2.7 “Defekt” do të thotë çdo pjesë e Punimeve e paperfunduar në përputhje me kontratën.
- 2.8 “Data e hyrjes” do të thotë data që Autoriteti Kontraktor lejon kontraktorin në kantier.
- 2.9 “Data e fillimit” eshte perfshire ne Të dhënat e kontrates. Ajo eshte data kur kontraktori do të filloje punimet e ndertimit. Në se kjo nuk realizohet, “data e fillimit “do te jete dita në të cilën do të paguhet paradhenia.
- 2.10 “Pajisje” do të thotë makineritë dhe veglat e kontraktorit të sjella përkohësisht në kantier për realizimin e Ndertimeve.
- 2.11 “Materiale” do të thotë të gjitha furnizimet, duke përfshirë ato të konsumit, të përdorura nga kontraktori për kryerjen e punimeve.
- 2.12 “Objekt i kontratës” do të thotë të gjitha Punët që kontraktori do të sigurojë sipas kushteve të kontratës.
- 2.13 “Palë(t)” do të thotë nënshkruesit e kontratës.
- 2.14 “Drejtues projekti” do të thotë personi i emëruar nga Autoriteti Kontraktor që është përgjegjës për administrimin e kontratës për Autoritetin Kontraktor.
- 2.15 “Autoritet Kontraktor” do të thotë Autoriteti Kontraktor qe eshte pjese e kesaj kontrate dhe që kontraktori punët objekt i kësaj kontrate.Ky term kudo qe përdoret ka kuptim të njëjtë me ate te perkufizuar ne ligj.
- 2.16 “Kantier” do të thotë vendi fizik i Punimeve.
- 2.17 “Raport i inspektimit të kantierit” do të thotë dokumentat e përfshira në dokumentat e tenderit që pasqyrojnë informacion faktik dhe të interpretuar rreth kushteve të sipërfaqes dhe nëntokës së kantierit.

"Ndërtim Tubacion Transmetimi Basen Presioni- Tunel- Partitar- Depo Daias".

- 2.18 "Nënkontraktues" do të thotë çdo person fizik ose ligjor ose kombinim i mësipërm, që furnizon Punët, materialet ose pajisjet për ose në emër të kontraktorit.
- 2.19 "Kontraktor" do të thotë personi fizik ose juridik që është palë e kësaj kontrate dhe sipas dispozitave të kësaj kontrate siguron Punimet.
- 2.20 "Standarte Teknike" do të thotë specifikimet e aprovuara nga një trup i posaçëm standartizimi për zbatimin e vazhdueshëm ose të përsëritur. Standarte të tilla përdoren si rregulla, rregullore ose përkufizim të karakteristikave për të siguruar se materialet dhe shërbimet e procesuara i përgjigjen qëllimit.
- 2.21 "Ngritja e kantierit" do të thotë punimet e ndërtimit të përkohshme, të ndërtuara e instaluara, që janë të nevojshme për zbatimin e punimeve të ndërtimit.
- 2.22 "Punime" do të thotë ajo që Autoriteti Kontraktor i kërkon nga kontraktori të gërmojë, ndërtojë, riparojë, rinovojë ose instalojë siç parashikohet në dokumentat e tenderit duke përfshirë shërbimet në lidhje me to, gjithashtu të përkufizuara në dokumentat e tenderit.

Neni 3: Hartimi i Kontratës

- 3.1 Njoftimi i ofertes fituese do të shërbejë për hartimin e kontratës midis palëve, e cila duhet të firmoset brenda afatit të shprehur në dokumentat e tenderit.
- 3.2 Ekzistenca e kontratës do të konfirmohet me nënshkrimin e dokumentit të kontratës duke sanksionuar të gjitha marrveshjet midis palëve.

Neni 4: Praktikë e Korrupsionit, Konflikti i Interesit dhe Kontrolli i Procesverbaleve

- 4.1 Autoriteti Kontraktor mund t'i kërkojë gjykatës të deklarojë të paligjshme kontratën nëse zbulon se kontraktori ka kryer veprime të korrupsionit. Veprimet e korrupsionit përfshijnë veprimet e përshkruara në Nenin 26 të Ligjit mbi Prokurimin Publik.
- 4.2 Kontraktori nuk duhet të ketë lidhje (të tashme ose të shkuara) me asnjë konsulent ose ent që ka marrë pjesë në përgatitjen e dokumentave të tenderit për këtë prokurim.
- 4.3 Kontraktori duhet të lejojë Autoritetin Kontraktor të inspektojë llogaritë dhe regjistrat që kanë lidhje me zbatimin e kontratës ose t'i kontrollojë ato me anë të kontrollorëve të emëruar nga Autoriteti Kontraktor.

Neni 5: Informacioni Konfidencial

- 5.1 Kontraktori dhe Autoriteti Kontraktues duhet të mbajnë në konfidencë të gjitha dokumentat, të dhënat dhe informacionet e tjera të dhëna nga pala tjetër në lidhje me kontratën.
- 5.2 Kontraktori mund t'i japë nënkontraktorit dokumenta të tilla, të dhëna ose informacione të tjera që merr nga Autoriteti Kontraktor deri në masën e kërkuar që nënkontraktorin të zbatojë punën e tij sipas kontratës. Në rast të tillë, kontraktori duhet të përfshijë në kontratën e tij me

"Ndërtim Tubacion Transmetimi Basen Presioni- Tunel- Partitar- Depo Daias".

nënkontraktorin një dispozitë që premtion ruajtjen e konfidencës siç thuhet në Paragrafin 5.1 më sipër.

Neni 6: Prona Intelektuale

- 6.1 Me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe në kontratë, të gjitha të drejtat e pronës intelektuale të siguruara nga kontraktori gjatë zbatimit të kontratës do t'i përkasin Autoritetit Kontraktor i cili mund t'i përdorë ato sipas gjykimit të tij.
- 6.2 Me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe në kontratë, kontraktori, pas përfundimit të kontratës, duhet t'i dorëzojë Autoritetit Kontraktor të gjitha raportet dhe të dhënat si hartat, diagramët, skicimet, specifikimet, planet, statistikat, llogaritjet dhe regjistrat mbështetës ose materialet e fituara, mbledhura ose përgatitura nga kontraktori gjatë zbatimit të kontratës. Kontraktori mund të mbajë kopje të këtyre dokumentave dhe të dhënave, po nuk duhet t'i përdori për qëllime që s'kanë lidhje me kontratën pa leje paraprake me shkrim nga Autoriteti Kontraktor.
- 6.3 Kontraktori duhet të garantojë Autoritetin Kontraktor zhveshjen nga përgjegjësia për shkelje të të drejtave të pronës intelektuale, që mund të dalin nga përdorimi i materialeve, skicave ose çdo prone tjetër sipas kontratës.
- 6.4 Në rast se ngrihet ndonjë pretendim ose padi kundër Autoritetit Kontraktor në lidhje me ndonjë shkelje të pronës intelektuale të shkaktuar nga zbatimi i kontratës ose nga përdorimi i materialeve, skicave ose çdo prone tjetër të mbrojtur e të furnizuar sipas kontratës, kontraktori duhet t'i japë Autoritetit Kontraktor të gjitha provat dhe informacionin në posedim të kontraktorit që kanë të bëjnë me këtë padi apo pretendim.

Neni 7: Origjina e Materialeve

- 7.1 Nuk ka asnjë kufizim për kombësinë e origjinës së materialeve, përveç atyre që mund të jenë përcaktuar në ndonjë Rezolutë të Asamblesë së Përgjithshme të Kombeve të Bashkuara.
- 7.2 Kontraktori mund të jetë i detyruar të verifikojë origjinën e materialeve.
- 7.3 Për qëllime verifikimi "origjinë" do të thotë vendi ku materialet janë nxjerrë, bashkuar ose prodhuar. materialet janë prodhuar kur, nëpërmjet prodhimit, procesimit, ose mbledhjes së mjaftueshme të komponentëve, rezulton një produkt i ri i njohur në tregti që është mjaft i ndryshëm në karakteristikat bazë ose në qëllim apo përdorim nga komponentët e tij.
- 7.4 Origjina e materialeve ka dallim nga kombësia e kontraktorit ose nënkombësia që furnizon me materiale.

Neni 8: Vendimet e Drejtuesit të Projektit

- 8.1 Drejtuesi i projektit do të vendosë për çështjet e kontratës midis kontraktorit dhe Autoritetit Kontraktor

"Ndërtim Tubacion Transmetimi Basen Presioni- Tunel- Partitar- Depo Daias".

- 8.2 Drejtuesi i Projektit mund të delegojë ndonjë nga detyrat dhe përgjegjësitë e tij tek të tjerët përveç zgjidhjen e mosmarrveshjeve dhe konflikteve. Drejtuesi i projektit duhet të njoftojë kontraktorin për delegimet e bëra apo të revokuara.

Neni 9: Komunikimi

- 9.1 Çdo komunikim midis palëve duhet të bëhet me shkrim.

Neni 10: Bashkëpunimi në Kantier me të Tjerët

- 10.1 Kontraktori duhet të bashkëpunojë dhe të ndajë kantierin me firma të tjera, autoritete publike, shërbimet publike dhe Autoritetin Kontraktor siç kërkohet dhe përkufizohet në Grafikon e realizimit të punimeve.

Neni 11: Përgjegjësia e Autoritetit Kontraktor

- 11.1 Autoriteti Kontraktor ka përgjegjësi të kompensojë kontraktorin për dëmtime të pajisjeve të kontraktorit deri në masën që lidhet me veprime me faj të Autoritetit Kontraktor ose të projekteve të Autoritetit Kontraktor me perjashtim të rastit kur keto të fundit, kishin gabime të dukshme që mund të ishin konstatuar lehtësisht nga kontraktuesi.

Neni 12: Raporti i Inspektimit të Kantierit dhe Kushtet e Kantierit

- 12.1 Autoriteti Kontraktor nuk mban asnjë përgjegjësi për konkluzionet ose interpretimet e bëra në raportin e inspektimit të kantierit.
- 12.2 Kontraktori pranon se i ka marrë të gjitha hapat e nevojshme për të verifikuar natyrën dhe vendin e Punimeve dhe se ka inspektuar dhe pajtohet me kushtet e përgjithshme dhe lokale që mund të ndikojnë në kryerjen ose koston e Punëve.

Neni 13: Kontraktori që Kryen Punimet

- 13.1 Kontraktori duhet të kryejë dhe mbarojë Punimet në përputhje me specifikimet teknike të paraqitura në dokumentat e tenderit.
- 13.2 Kontraktori nuk mban përgjegjësi për gabimet në projekt, të dhëna, planimetri ose aspekte të tjera të specifikimeve teknike, të dhëna nga Autoriteti Kontraktor, me përjashtim të rasteve kur gabimi ishte aq i dukshëm sa kontraktori duhet ta kishte vënë re dhe ta kishte reklamuar këtë të Autoriteti Kontraktor.
- 13.3 Kodet dhe standartet që do zbatohen do të jenë të shprehura në dokumentat e tenderit. Nëse gjatë ekzekutimit të kontratës, ka ndryshime në zbatimin e kodeve ose standarteve, këto ndryshime do të zbatohen vetëm pasi të jenë aprovuar nga Autoriteti Kontraktor.

Neni 14: Ekzekutimi i Punimeve

- 14.1 Kontraktori duhet të fillojë zbatimin e kontratës menjëherë sapo ta lidhe atë dhe duhet t'i mbarojë Punët brenda Afatit të Mbarimit.

"Ndërtim Tubacion Transmetimi Basen Presioni- Tunel- Partitar- Depo Daias".

Neni 15: Ngritja e Kantierit

- 15.1 Kontraktori mban përgjegjësi për projektin e Ngritjes se Kantierit.
